



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe për kthim

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, 15.12.2016 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe për kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Ceku – nënkryetari i parë i Komisionit dhe anëtarët Mufera Sinik, Çerim Bajrami, Ali Berisha, Veton Berisha, Kimete Bytyqi.

Munguan: Jasmina Zhivković – kryetare dhe anëtarët Sasha Milosavljević, Sllavko Simiq, Millka Vuletiq, Danush Ademi.

Pjesëmarrësit tjerë: monitoruesi i OSBE-së dhe i Këshillit konstituv të komuniteteve, përfaqësuesi i KDI dhe përfaqësuesi i Ambasadës së Zvicrës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur më 6.11.2016,**
- 3. Shqyrtimi i Projekt raportit për mbikëqyrjen e nenit 11. të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës,**

4. **Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri,**
5. **Të ndryshme.**

Nënkryetari i Komisionit konstatoi miratimin e rendit të ditës dhe vazhdoi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit e mbajtur më 6.11.2016

Nënkryetari i Komisionit konstatoi që procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 06.11.2016 është miratuar pa vërejtje dhe hapi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Projekt raportit për mbikëqyrjen e nenit 11. të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës

Veton Berisha tha se ky komision, në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrjen e ligjit dhe në kuadër të Planit të punës për vitin 2016, ka vendosur të bëjë monitorimin e implementimit të nenit 11. të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të përcaktimit të shkallës së implementimit të këtij neni në praktikën e punësimit të komunitetit joshumicë në shërbimin civil.

Ai, në cilësinë e raportuesit dhe kryetarit të Grupit të punës për monitorimin e implementimit të nenit 11. të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, ka prezantuar Projekt raportin dhe elementet kyçe të këtij monitorimi që është realizuar në disa faza:

- në fazën e parë, nga Zyra ligjore e Qeverisë dhe Ministria e administratës publike janë kërkuar informacionet zyrtare për implementimin e legjislacionit relevant në lidhje me përfaqësimin e komunitetit joshumicë në administratën publike të Kosovës,

- në fazën e dytë, ky komision nga KDI ka kërkuar hulumtim parlamentar në temën “Përfaqësimi i komunitetit joshumicë në organet shtetërore të Kosovës”, me qëllim të vlerësimit të gjendjes aktuale të përfaqësimit të komunitetit joshumicë në organet shtetërore, në aspektin e zbatimit të politikave të cilat rregullojnë përfaqësimin e komunitetit joshumicë në institucionet e nivelit qendror e lokal, si dhe a ka përfaqësim adekuat,

- në fazën e tretë, ky komision ka organizuar një debat publik , në të cilin kanë qenë të thirrur për raportim ministri i Ministrisë së administratës publike dhe organet tjera shtetërore, me qëllim të përmbledhjes së informacioneve, të shpjegimeve dhe të dhënave tjera në lidhje me implementimin praktik të ligjit dhe çështjeve të tjera të cilat lidhen me implementimin e ligjit të interesit publik,

- në fazën e katërt, Grupi i punës në bashkëpunim me personelin që mbështet punën e Komisionit ka përpiluar Projekt raportit i cili gjendet para Komisionit për shqyrtim dhe miratim, si dhe për procedim të mëtejme Kuvendit.

Ai shtoi që Grupi i punës, në bazë të adresimeve me shkrim institucioneve, hulumtimeve parlamentare, debateve publike të organizuara, raportimeve të ministrave e autoriteteve tjera, ka arritur të përmbledhë të dhëna, rekomandime dhe të identifikoj vështirësitë në punësimin e komunitetit joshumicë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Grupi i punës në bazë të problemeve të identifikuara ka konstatuar që neni 11. i Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, me gjithë vështirësitë e caktuara, implementohet, si dhe që duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes aktuale, me qëllim të ngritjes së shkallës së implementimit të këtij ligji dhe të rritjes së përgjegjësisë institucionale, përfaqësimit të komuniteteve në sektorin publik, në nivelin qendror e lokal.

Kimete Bytyqi tha se Raporti në krahasim me kushtet e pacaktuara me ligj dhe me qëllim të vërtetimit të respektimit të parimeve ligjore nga ana e institucioneve qeveritare analizon të dhënat statistikore, paraqet të dhëna dhe konstatime të rëndësishme, paraqet disa rekomandime institucioneve përgjegjëse, me qëllim të ndërmarrjes së masave pozitive për rritjen e shkallës së punësimit të komunitetit joshumicë në shërbimet e administratës publike.

Ajo propozoi që anëtarët e Grupit punues të organizojnë edhe një mbledhje, me qëllim të harmonizimit të rekomandimeve, dhe më pastaj Komisioni ta miratoj Raportin dhe të njëjtin t`ia procedoj Kuvendit.

Agim Çeku, nënkryetari i Komisionit, konstatoi që njëzëri është miratuar propozimi për shtyrjen e shqyrtimit, deri në mbledhjen e ardhshme, të Projekt raportit për mbikëqyrjen e implementimit të nenit 11. të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, me qëllim të harmonizimit të propozimeve.

Nënkryetari i Komisionit e hapi për shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri

Komisioni, meqë nuk kishte vërejtje dhe diskutime në Projekt ligjin me raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, ka nxjerrë këtë:

Përfundim

Projekt ligjit nr. 05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandohet Kuvendit që të njëjtin ta miratojë në shqyrtimin e dytë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35.

Njësia për mbështetje Komisionit

Nënkryetari i Komisionit

Agim Qeku